

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL MITROVICË**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **642-26-787-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **Trajtimi i qenëve endacak që bredhin lirshëm në Komunën e Mitrovicës**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	<b>MITRO VET SH.P.K.</b>
NUI	<b>810171447</b>
Adresa	<b>Adem Voca</b>
Vendi	<b>Mitrovicë</b>
Kodi postar	<b>40000</b>
Numri Telefonit	<b>+38349818202</b>
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	<b>Labinot Osmani</b>
Adresa elektronike	<b>mitrovet@gmail.com</b>
Data e parashtrimit të ankesës	<b>06.05.2026</b>

*\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

#### 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

Emri i avokatit  
Adresa e plotë  
Numri i Telefonit  
Numri i faks-it  
Adresa elektronike

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

**Trajtimi i qenëve endacak që bredhin lirshum në Komunën e Mitrovicës**

**Trajtimi i qenëve endacak që bredhin lirshum në Komunën e Mitrovicës**

**Njoftimi për kontrate 25.02.2026**

**Afati i fundit për dorëzimin e tenderëve 06.04.2026**

**Kerkese për rishqyrtim 19.03.2026**

**Vendim mbi refuzimin e Kerkese për Rishqyrtim 26.03.2026**

**Ankese në OSHP 03.04.2026**

**Vendimi i OSHP-se OSHP: 2026/0211 dt 04.05.2026**

**Formular B54 për korigjimin përmesimit të DT , dt 05.05.2026**

**Afati i fundit për dorëzimin e tenderëve dt 06.05.2026**

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

### 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

**Pas udhëheqjes së procedurës paraprake për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, në kuptim të nenit 108/A par 7 ndërlidhur me Nenin 109 të LPP-së, duke qenë pale me interes, i drejtohem Organit Shqyrtues të Prokurimit me këtë Ankesë , për vendosje meritore ndaj pretendimeve tona të cilat janë refuzuar pa baze ligjore nga AK.**

## **7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Neni 1

Neni 7

Neni 28

Neni 53

Neni 69 Rregullorja nr 01/2024 per Prokurim Publik

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejtshme ose mashtruese.*

## **8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

MITRO VET SH.P.K. në cilësinë e operatorit ekonomik të interesuar, paraqet këtë ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Trajtimi i qenëve endacak që bredhin lirshëm në Komunën e Mitrovicës”, duke pretenduar për shkelje të dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik nga ana e Autoritetit Kontraktues – Kuvendi Komunal Mitrovicë dhe mos respektim/zbatim të vendimit të OSHP-së : OSHP: 2026/0211 dhe OSHP : 349/25 referuar këtij aktiviteti të prokurimit. Në këtë aktivitet të prokurimit pas publikimit të njoftimit për kontratë dhe përcaktimit të kushteve të Dosjes së Tenderit, të cilat kemi konsideruar se janë diskriminuese/favorizuese dhe ne kundërshtim me ligjin e prokurimit publik dhe dispozitat e tjer, a ne si operator ekonomik kemi paraqitur kërkesë për rishqyrtim me datë 19.03.2026 pranë AK , e cila është refuzuar nga Autoriteti Kontraktues me datë 26.03.2026.

Pas kësaj, në përputhje me nenin 108/A dhe 109 të LPP-së, kemi ushtruar Ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Me datë 04.05.2026, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka nxjerrë vendim me të cilin ka aprovuar si të bazuar Ankesën e OE Mitro Vet Shpk . Në arsyetimin e këtij vendimi, Paneli Shqyrtues ka theksuar se procedurat e prokurimit duhet të zhvillohen në mënyrë të drejtë, pa diskriminim dhe me qëllim të sigurimit të një procesi efektiv dhe konkurrues.

Menjëherë pas këtij vendimi, respektivisht me datë 05.05.2026, Autoriteti Kontraktues ka publikuar një Formularin B54 njoftim për informata shtesë / përmirësim gabimi, përmes të cilit ka ndryshuar afatin për dorëzim të ofertave, duke e caktuar atë për datën 06.05.2026. Kjo do të thotë se operatorëve ekonomik u është lënë në dispozicion vetëm një (1) ditë

kohë efektive për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertave pas përfundimit të procedurës ankimore dhe publikimit të njoftimit përkatës.

Një veprim i tillë i Autoritetit Kontraktues përbën shkelje të drejtpërdrejtë të parimeve themelore të prokurimit publik dhe dispozitave përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik.

Konkretisht, gjatë periudhës deri më 04.05.2026, aktiviteti i prokurimit ka qenë në shqyrtim – I pezulluar pranë OSHP-së dhe si i tillë ka qenë i pasigurt në aspektin juridik për operatorët ekonomik, të cilët nuk kanë pasur siguri nëse procedura do të vazhdojë, do të ndryshohet apo do të anulohet.

Vetëm pas nxjerrjes së vendimit të OSHP-së është krijuar qartësi lidhur me vazhdimin e procedurës, dhe rrjedhimisht vetëm nga ky moment mund të konsiderohet se operatorët ekonomik kanë pasur bazë reale për përgatitjen e ofertave.

Në këtë kontekst, caktimi i një afati prej vetëm një dite është joproporcional, joreal dhe në kundërshtim me çdo standard të arsyeshëm të prokurimit publik, pasi pamundëson përgatitjen serioze dhe profesionale të ofertave.

Një afat i tillë në praktikë kufizon pjesëmarrjen, redukton konkurrencën dhe krijon avantazh të padrejtë për operatorë të caktuar që mund të kenë qenë të përgatitur paraprakisht, duke cenuar drejtpërdrejt parimin e trajtimit të barabartë të paraparë me nenin 7 të LPP-së.

Për më tepër, edhe dispozitat e LPP-së që rregullojnë dhënien e informatave sqaruese dhe plotësuese parashohin se në rastet kur informatat e tilla ndikojnë në përgatitjen e ofertave, duhet të sigurohet një periudhë e mjaftueshme kohore për operatorët ekonomik, respektivisht një afat minimal prej dhjetë (10) ditësh. Në rastin konkret, edhe pse formalisht nuk janë ndryshuar kushtet e Dosjes së Tenderit, fakti që procedura ka qenë në shqyrtim pranë OSHP-së dhe vetëm pas datës 04.05.2026 është bërë e qartë vazhdimi i saj, përbën në vetvete një informacion thelbësor që ndikon drejtpërdrejt në vendimmarrjen dhe përgatitjen e ofertave nga operatorët ekonomik. Për rrjedhojë, mosrespektimi i këtij standardi kohor përbën shkelje të qëllimit dhe frymës së ligjit.

Gjithashtu, ndonëse Autoriteti Kontraktues formalisht ka vazhduar procedurën në përputhje me vendimin e OSHP-së, në substancë ai nuk ka siguruar zbatim efektiv të këtij vendimi, pasi përmes caktimit të një afati kaq të shkurtër ka bërë që operatorët ekonomik të mos kenë mundësi reale për të marrë pjesë në mënyrë të barabartë në këtë procedurë.

Një veprim i tillë bie ndesh edhe me vetë arsyetimin e Panelit Shqyrtues, i cili kërkon që procedurat të zhvillohen në mënyrë të drejtë dhe pa diskriminim.

Për më tepër, mënyra e veprimit të Autoritetit Kontraktues, përkatësisht kjo nguti dhe caktimi i një afati minimal, krijon dyshime të arsyeshme se procedura nuk është duke u zhvilluar në funksion të konkurrencës së lirë, por potencialisht në funksion të favorizimit

të një operatori ekonomik të caktuar.

Kjo për arsye se një operator ekonomik që pret përfundimin e procedurës ankimore nuk ka pasur mundësi reale për përgatitje brenda një dite, ndërsa një operator që mund të ketë qenë paraprakisht i përgatitur do të kishte avantazh të dukshëm

Në këto rrethana, veprimi i Autoritetit Kontraktues për caktimin e një afati prej vetëm një dite për dorëzim të ofertave përbën shkelje të nenit 7 dhe nenit 53 të LPP-së, si dhe të parimeve të proporcionalitetit, sigurisë juridike dhe konkurrencës efektive.

Andaj, duke u bazuar në sa më sipër dhe në detyrimin për zbatim të plotë dhe efektiv të vendimit të OSHP-së, i propozojmë Organit Shqyrtues të Prokurimit që ta aprovojë këtë ankesë si të bazuar dhe të obligojë Autoritetin Kontraktues që të veprojë në përputhje me vendimin e OSHP-së, si dhe të rivendosë një afat të arsyeshëm për dorëzimin e ofertave, në mënyrë që të sigurohet pjesëmarrje reale dhe konkurrencë e drejtë ndërmjet operatorëve ekonomik

## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Jane deme te konsiderueshme te cilat mund te na shkaktohen pasi qe nuk eshte siguruar qasje e drejte dhe e barabarte per te gjithë OE ne perputhje me standardet e aplikueshme sipas ligjit , dhe nga ky percaktim diskriminues/favorizues , rrezikon qe te mos trajtohen ne menyre te barabarte te gjithë OE**

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,

- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*